

VENDIM
Nr. 54, datë 7.3.2018

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “AED SOLAR” SHPK, PËR LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPIANTI FOTOVOLTAIK TOPOJË, ME KAPACITET PRODHUES 1998 kw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 4, pika 1, germa “a”; të neni 5, pika 1, germa “a”; të nenit 8; të nenit 10, pika 2 dhe 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “AED Solar” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë, me fuqi të instaluar 1998 kw,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 3 prot., datë 1.2.2018, shoqëria “AED Solar” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë, Bashkia Fier, me kapacitet prodhues 1998 kw.

- Autorizimi me nr. 4867/6 prot., datë 27.10.2016, i lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i paraqitur në ERE nga subjekti “AED Solar” sh.p.k., nuk i përket kësaj shoqërie por shoqërisë “Albanian General Electricity” sh.p.k.

- Rezulton se aplikuesi, shoqëria “AED Solar” sh.p.k. nuk ka autorizim të vlefshëm për këtë aplikim, sipas nenit 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”.

- Në bazë të nenit 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni”, theksohet se akti administrativ i cili i jep mbajtësit të saj të drejtën për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni, miratohet nga ministri, për objektet deri në 2 mw, ndërsa mbi 2 mw, nga Këshilli i Ministrave.

- Aplikimi i shoqërisë “AED Solar” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”), paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a” dhe “b”) paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për Impiantin Fotovoltaik (neni 9, pika 4.4.1, pika 4.4.2, pika 4.4.3, gjerat “a”, “b”, “d”; pika 4.4.4, gjerat “a”, “b”, “d”) paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “d” (vërtetim datë 20.12.2017, lëshuar nga Gjykata Penale e Shkallës së Parë Tiranë, për përfshirje ose jo në një proces penal); germa “f” (marrëveshje ose autorizimi nga KM-

ja); germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti);

- Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit) dhe germa “d” (vërtetimin e pagesës për aplikim në llogari të ERE-s), e kryer pjesërisht;

- Neni 9, pika 4.4.3, germa “c” (shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria); pika 4.4.4, germa “c” (oponenca teknike e projektit); germa “e” (miratimi i zbatimit të projektit nga MIE) dhe pika 4.4.5 (leje nga institucione të tjera),

do të njoftohet subjekti që në zbatim të nenit 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato në ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AED Solar” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Impianti Fotovoltaik Topojë, me fuqi të instaluar 1998 kw.

2. Nëse shoqëria “AED Solar” paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6, të nenit 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, brenda 1 muaji nga marrja e këtij vendimi dokumentacioni i vlefshëm i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S

Erjola Sadushi